



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-11747 dt. 12.03 2021

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Komunës së Drenasit z. Labinot Halilaj, me dt: 19.03.2021 (E Premte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 19.02.2021.
2. Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare „Dr. Hafir Shala” Drenas (Glogoc)
3. Draft-Raport i tretë periodik për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
4. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e katër fushave sportive në zonat kadastrave Korroticë e Poshtme, Terstenik, Dobroshec dhe Llapushnik.
5. Të ndryshme.

Drenas, 12.03.2021



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Nr. 12-060/dj 11310 dt. 10.03 2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 19.02.2021, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi dhe Blerina Gashi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe pronë: Ruzhdi Lestrani Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Arsim Haxhiu dhe zyrtarja për shëndetësi dhe banim social Albulena Hetemi.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 22.01.2021.
2. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu , i plotësuar.
3. Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2020.
4. **Propozim** Vendim për shfuqizimin e pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 2, të Vendimit Nr. 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënien në Shfrytëzim të Përkohshëm të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues të ri të Banimit të Përkohshëm Social.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës , pasi nuk pati diskutime hodhi në votim rëndin e ditës , u votua në mënyre unanime .

Hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KPF-ca dt. 22 .01.2021.**

Ka diskutime jo, hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës , dhe kjo pike u votua ne mënyrë unanime.

Kalojm te pika e dytë: Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu , i plotësuar.

Fjalën ja kaloi drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani në e përputhje me kërkesën e Ministrisë se Pushtetit Lokal, rrjedhimisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Komuna e Drenasit ka ndërmarr veprimet konkrete me qëllim të harmonizimit të vendimit të Kuvendit të komunës me kërkesën e MEA-së.

Duke pasur parasysh kontributin e dhënë të Dëshmorit të Kombit për çlirimin e vendit, Komuna e Drenasit cakton lokacionin për vendosjen e shtatores së heroit “Asllan Fazliu”.

Familja Fazliu, ka ndërtuar shtatoren e heroit ”Asllan Fazliu” me kontributin e familjes dhe bashkëluftëtareve të heroit, ndërsa Komuna e Drenasit merr për obligim caktimin e lokacionit për vendosje të shtatores.

Familja është pajtuar me rekomandimin e kryetarit të komunës, që të pritët deri në përfundim të ndërtimit të sheshit që parashihet të ndërtohet në parcelën P-778-4, në mënyrë që atë të vendoset shtatorja.

Andaj, vendosja e shtatores në parcelën nr. P-778-4, në zonën kadastrale në Drenas, është bërë me propozimin e Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci dhe dakordimin e plotë të familjes Fazliu, pas komunikimeve zyrtare të shkëmbyera si dhe takimit të zhvilluar me datë 28.01.2021. Familja Fazliu dhe Institucioni i Komunës së Drenasit të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës janë pajtuar që vendosja e shtatores se heroit të kombit “Asllan Fazliu”, në parcelën 778-4, do të bëhet pas përfundim të sheshit i cili parashihet që të ndërtohet në 2-3 vitet e ardhshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj:ka dikush diçka hedhim në votim u votua në mënyrë unanime.

Kalojm te pika e tretë: Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2020. A ka dikush diçka pra ky është raport nuk votohet vetëm rekomandohet për kuvend.

Kalojm te pika e katërt: Propozim Vendim për shfuqizimin e pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 2, të Vendimit Nr. 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënien në Shfrytëzim të Përkohshëm të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues të ri të Banimit të Përkohshëm Social.

Fjalën e merr Drejtori i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale Arsim Haxhiu – Lidhur me propozim vendimin bazuar në detyrat zyrtare të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe zyrtares që është për shëndetësi dhe banim social. Faktikisht gjatë periudhës së ndarjes së banesave të banimit të përkohshëm social dhe kontrolleve që ju ka bërë , ka ardhur në përfundim komisioni së kanë qenë tre familje të cilat nuk kanë banuar në harmoni më ligjin e banimit të përkohshëm social. Kanë qenë disa herë nuk i kanë gjetur aty , kështu që komisioni i përberë prej shtatë anëtarësh ka ardhur në përfundim se ato dy-tri banesa duhen të plotësohen ,mbështetur në vendimin e kaluar që ka qenë në kuvend dhe ju kanë ndarë tri familjeve tjera të cilat kanë nevojë të strehohen përkohësisht.

Burim Bujupi – Para se të ju a marrim banesat këtyre tri familjeve që i keni vizituar dhe nuk i keni gjetur aty , desha të ju pyes a i keni kontaktuar së paku në telefon dhe më ditë arsyen.

Albulena Hetemi – Më Ligjin Nr. 03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, të dala nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Programin Komunal tre Vjeçar për Banim Social 2019-2021, me Vendimin nr. 12-020-11267 të datës 27.02.2019 është formuar Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm.

Gjatë punës së vet Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social është angazhuar maksimalisht që këtë mision ta kryej me nderë dhe përgjegjësi të lartë, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët relevant për ta jetësuar në përpikëri këtë mision të tij.

Në Bllokun I dhe Bllokun II, në Drenasin III, të Banimit të Përkohshëm Social janë gjithsej **50 banesa**, **46** prej tyre janë duke u shfrytëzuar nga shfrytëzuesit e përcaktuar me kontratë, në mënyrë të rregullt, ndërsa **4**, jo. Rrjedhimisht, konstatohet se në Banesat në **Bllokun I** dhe në **Bllokun II** të Banimit të Përkohshëm Social, faktikisht janë të lira këto banesa:

Banesa me nr. 14, Kati i II-të, në Blloku II, e cila i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm znj. **Bahtije Feka**, me të cilën është lidhur kontrata me Nr. 01/360-25959 e dt. 16.11.2020 në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokolli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019 për dhënien në shfrytëzim të banesës së lartë cekur, mirëpo e njëjta nuk e ka marrë kopjen e kontratës, përkundër thirrjeve telefonike nuk është lajmëruar, gjithashtu sipas konstatimeve të komisionit për verifikimin e banimit të përkohshëm social nuk është vendosur fare në banesë, pra nuk është duke banuar, (evidentimi i komisionit për verifikim të gjendjes së banesave në tri (3) procesverbale), gjë që e ka humbur të drejtën e shfrytëzimit të kësaj banese.

Banesa nr. 9, Kati III/A në Bllokun II, i është dhënë në shfrytëzim znj. **Hava Deliu**, e cila e ka nënshkruar kontratën, me Nr. 01/360-25953, me dt. 16.07.2020, në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokolli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, mirëpo nuk e ka marrë kopjen e kontratës dhe gjithashtu nuk është vendosur fare në banesën e lartë cekur, përkundër thirrjeve telefonike nuk është lajmëruar, gjithashtu komisioni në përbërje të plotë e ka verifikuar gjendjen faktike dhe ka konstatuar se banesa është e mbyllur dhe faktikisht nuk është duke banuar askush, (evidentimi i komisionit për verifikim të gjendjes së banesave në tri (3) procesverbale), gjë që e ka humbur të drejtën e shfrytëzimit të kësaj banese.

Banesa me Nr. 2, Llam. B.P., Blloku II, me vendim të Kuvendit Komunal me Nr. protokolli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, i është ndarë në shfrytëzim znj. **Hajrie Makolli** për shkak të gjendjes ekonomike jo të mirë, mirëpo e lartë cekura nuk ka pranuar të nënshkruaj kontratën dhe ka dhënë deklaratë me shkrim për refuzimin e banesës në fjalë, që do të thotë se e njëjta vullnetarisht ka hequr dorë nga shfrytëzimi i banesës në fjalë.

Banesa nr. 1 përdhese/ A në Bllokun II, me vendim të Kuvendit Komunal me Nr. protokolli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm **Kifete Gjelit**- nënë kryefamiljare (me të cilën është lidhur kontrata me Nr. 01/360-25962, me dt. 16.07.2020, për shfrytëzimin e përkohshëm të banesës).

Marrë parasysh gjendjen aktuale Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social vendosi që të zhvilloj procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi, përkatësisht në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimeve Administrative, përkatësisht bazuar në nenin 13 të tij lidhur me shkëputjen e kontratës së qirasë, ku thuhet se “Organi kompetent komunal, shkëput kontratën për qiranë në rastet kur: 1. Qiramarrësi ka bërë deklaram të rrejshëm për të ardhurat, 2. Qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk ka njoftuar organin kompetent komunal. Gjithashtu Neni 8 i Kontratës mbi Shfrytëzimin e Përkohshëm të Banesës me Qira Joprofitabile, të lidhur me dt. 16.07.2020, në

mes të Komunës së Drenasit dhe palës përfituese, thotë “Qiradhënësi ka të drejtë të shkëpusë kontratën nëse qiramarrësi i shkel kushtet e kontratës”.

Andaj propozojmë që të bëhet shfuqizimi i pikës 1, 2 dhe 3 të Vendimit të Kuvendit Komunal me nr. protokolli 12/360-68569, të dt. 29.11.2019 për dhënien në Shfrytëzim të Përkohshëm të Banesave Sociale në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, për përfituesit e lartë cekur të Banimit të Përkohshëm Social.

Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social, verifikoj dokumentacionin dhe gjendjen në teren të kërkesave për strehim. Përzgjedhja është bërë nga lista e pritjes së familjeve të cilat kanë aplikuar për strehim, në bazë të kriterëve të përparësisë të parapara në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, si statusi i banimit, lartësia e të ardhurave, gjendja shëndetësore, invaliditeti si dhe struktura e familjes. Pas vizitave në teren të datës 21.01.2021, Komisioni rekomandoi që **Banesa me nr. 9, Kati III/A në Bllokun II**, t’i ipet për banim të përkohshëm familjes së **Ardian Ukës**, nga fshati **Gradicë**, Komuna e Drenasit. Kjo familje jeton në një shtëpi të vjetër në kushte të vështira socio-ekonomike. Kjo familje ekzistencën e vet e siguron nga ndihma sociale (evidentimi i komisionit në teren gjendet në procesverbal).

Gjithashtu me datën 25.01.2021, Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social, ka vizituar në teren familjen e **Fatbardha Mujës**, e cila rreth dy javë më herët është vendosur me familjen e saj katër anëtarëshe në **Banesën me nr. 2 Llamella. B. P, Blloku II**, për shkak të kushteve të vështira socio-ekonomike. Kjo familje katër anëtarëshe ekzistencën e vet e siguron nga ndihma sociale. Andaj propozohet që për hire të gjendjes së vështirë socio-ekonomike të familjes së Fatbardha Mujës- nënë kryefamiljare t’i njihet e drejta sipas dispozitave ligjore për shfrytëzim të banesës së lartë cekur, (evidentimi i komisionit në teren gjendet në procesverbal).

Me pranimin e shkresës zyrtare (emali-it zyrtar) të dt. 23.02.2021, të Qendrës për Punë Sociale dhe në bazë të kërkesës me nr. protokolli 06-070/01-46597, të dt. 27.10.2020 të Bashkim Delit, DSHMS në bazë të detyrës zyrtare njoftoj komisionin dhe me dt. 25.02.2021 Komisionit për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social, mbajti edhe një takim, duke qenë se ky rast është trajtuar nga ana e Organit të Kujdestarisë të QPS-së në Gllogoc, ku i njëjti ka qenë i përsëritur sërish më dt. 26.07.2020, gjithashtu kjo familje i ka kushtet e vështira sociale dhe ekonomike. Organi i Kujdestarisë sipas detyrës zyrtare ka punuar rreth tejkalimit të vështirësive familjare. Andaj Komisioni duke e marrë si rast urgjent bazuar në gjendjen sociale dhe ekonomike të rëndë propozon që kjo familje të vendoset përkohësisht në **Banesën me nr. 1, Përdhese/A në Bllokun II (21.50 m²)**.

Pra nga kjo që u tha më lartë propozojmë që të lejohet lidhja e kontratave për dhënien e banesës me qira joprofitabile për kohë të caktuar me këta përfitues të rinjë të cilët kanë bërë kërkesa për strehim:

1. **Banesën me nr. 9, Kati i III-të/A, në Blloku II**, t’i epet në Shfrytëzim të Përkohshëm, (deri në thirrjen publike të ardhshme për aplikim), **z. Ardian Uka**.
2. **Banesa me nr 14, Kati i II-të, në Blloku I**, t’i jepet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), **znj. Kifete Gjeli**- nënë kryefamiljare, përkatësisht të transferohet nga Banesa me Nr. 1, Përdhese /A, në Bllokun II, tek banesa e lartë cekur, për shkak se është banesë teknikisht e pabanueshme.

3. **Banesa me nr. 2, Llam. B. P., në Bllokun II**, t'i jepet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), **znj. Fatbardha Muja-nënë kryefamiljare**.
4. **Banesa me nr. 1, Përdhese/A, në Blloku II**, t'i jepet në shfrytëzim të Përkohshëm, (për kohë të caktuar, deri në thirrjen e ardhshme publike për aplikim), **z. Bashkim Deliu**.
5. Ky propozim vendim vie në përputhje me dispozitat ligjore në mënyrë që të arrihet qëllimi i Programit të Banimit të Përkohshëm Social dhe tu mundësohet zgjidhja e nevojave të banimit familjeve të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike ta zgjidhin këtë problem.
Burim Bujupi- Faleminderit për sqarimin. Në fakt po i bie që edhe një banesë qenka e lirë, teknikisht e pa banuar. Unë kam edhe një kërkesë ndoshta herën tjetër kishte qenë mirë që çdo banesë që jepet më e ditë dhe të paktën për metrin katror ,çfarë metri katror kanë, sepse këtu po mungojnë të dhënat. P.sh për 27m katror ne menjëherë e dimë që nuk i plotëson kushtet për tre anëtare familjes edhe është arsyetimi më i fuqishëm.

Fjalën e merr Drejtori i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale Arsim Haxhiu- Edhe një sqarim rreth kësaj , të ajo banesa që thamë , faktikisht për shkak të presioneve dhe numrit të madh të kërkesave që po behën kur po kanë këto komisionet ajo ka qenë e dedikuar për lokal afarist dhe është shfrytëzuar përkohësisht dhe tashme është e lirë ose e pabanueshme. Ne kemi ardhur në disa bisedime fillestare që më e bërë një kërkesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për arsye se kanë disa fonde të cilat ne qoftë se na duhet më ndryshua edhe projektin të kthehet prej një lokali afarist në një lokal për banim ose të lihet rezervë për banim urgjent se ka këso lloj kërkesash p.sh. javore, mujore, dhe mund të kemi ndonjë kërkesë të tillë të natyrës së shërbimeve sociale por megjithatë ajo kërkon fond një investim në mënyrë që të jetë e banueshme dhe ti plotësojë kushtet elementare minimale teknike për banim. Si e tillë për momentin është e zbrazët për arsye se ne nuk mund të marrim një vendim ose një propozim vendim që të jepet banesa dhe nuk kemi aso lloj kërkesash që të jepet për një muaj ose një javë për më i bërë zgjidhje.

Burim Bujupi – Drejtor a kemi shumë kërkesa për banim - banesa- strehim?

Fjalën e merr Drejtori i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale Arsim Haxhiu- Kërkesa kemi çdo ditë dhe një prej vështirësive me të mëdha është kjo për arsye se kemi përpjesëtim të familjeve. Në krahasim të kërkesave të këtij viti dhe të vitit të kaluar dhe atij paraprak janë kërkesa të themi një numër mund të përsëriten dhe janë kërkesa të reja dhe faktikisht dhe është një prej shkaqeve të këtij numri të kërkesave është përpjesëtimi i familjeve. Në aspektin ligjorë ne jemi përgjegjës vetëm për banim të përkohshëm , tash në nivel të komunës më sa di unë ka disa marrëveshje me organizata jo-qeveritare për ndërtim të shtëpive , natyrisht në trojet e tyre. Besoj është forma më e mirë që e zbutet këtë çështje për arsye se deri tash edhe mentaliteti i banimit social deri në thirrjen publike që e kemi pasur vitin e kaluar që ju ka dhënë një banesë dhe tash është e vazhdueshme ,kështu pak edhe ata kanë filluar se janë përkohësisht , për aq kohe sa është e nevojshme , natyrisht maksimum kontratat janë bërë dy vite për ta dhe nuk është çudi që ndoshta të ardhmen mund merret një vendim varësisht prej kërkesave që të jetë një vjeçar ose me dy vite. Ka kërkesa por nga aspekti ligjor ne jemi përgjegjës vetëm për banim të përkohshëm. Ndërsa kjo çështje e ndërtimit të shtëpive është një projekt më i gjerë në mes të Komunës dhe OJQ-ve, ne faktikisht në qershor zakonisht të gjitha kërkesat i adresojmë qoftë **OJQ-ve** që funksionojnë në **Kosovë , ambasadave , ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor , ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale** së kemi kaq kërkesa. Natyrisht se ne kemi një komision brenda drejtorisë që bën një farë vlerësimi për arsye se ne kemi një softwarë

që është investuar nga **ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinore**, përkundër aplikimit ndoshta kompania që e ka projektuar këtë software duhet të ketë parasysh diçka për arsye se ka kërkuar shumë dokumentacion dhe çka kemi vërejtur dhe komisioni ka vërejtë një element se vlerësohen në bazë dokumentacionit tash disa që janë të zhdërvjelltë në kuptimin e nxjerrjes së letrave po shohim se po ju shkon më poenë diku **100%**. Pjesa tjetër që vërtete e kanë pasur gjendjen shumë të vështirë e kemi parë që kanë mbetur më **30-40** poenë edhe komisioni të paktën rekomandimin tonë që më dal me i shikua rastet, thjesht me i shikua te jetë përsëri edhe këtë vit, do te jetë sigurisht e mundimshme nuk do të jetë e lehtë. Krahas dokumentacionit do të jetë analiza reale e gjendjes sociale, ekonomike, shëndetësore e familjeve që kanë nevojë për banim të përkohshëm.

Kalohim te pika e pestë 5. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 50min.

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku Subashi



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	10.03.	2021	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	110/14	11155	



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit

PROPOZIM STATUTI

I

QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

“Dr. Hafir Shala” Drenas (Glogoc)

DRAFT STATUTE

of the

MAIN FAMILY MEDICINE CENTER

“Dr. Hafir Shala” Drenas (Glogoc)

PREDLOG STATUT

GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE

“Dr. Hafir Shala” Drenas (Glogovac)

Në vështrim të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dispozitave të nenit 17, paragrafi 17.1, pika j të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të nenit 18 paragrafi 3 në lidhje me nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, Udhëzimit administrativ 04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor, dispozitave të nenit 34.6 nëpika f të Statutit të Komunës së Glllogocit të aprovuar në vitin 2008, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2021, të aprovoi:	In observe of article 58 paragraph 1 point (h) of the Law on Local Self-Government No. 03 / L-040, article 72 of the Statute of the Municipality of Drenas, the Mayor of Drenas, proposes: based on the provisions of article 12, paragraph 12.2, point d, provisions of Article 17, paragraph 17.1, point j of Law No. 03 / L-040 on Local Self-Government, provisions of Article 18 paragraph 3 in conjunction with Article 45 paragraph 1 and 2 of Law No. 04 / L -125 on Health, Administrative Instruction 04/2020 Primary Health Care, regulations for article 34.6 sub-point f for the Statute of the Municipality of Glllogoc approved on 2008, the Municipal Assembly of Drenas in the meeting held on _____ 2021, to approve:	S obzirom na član 58 stav 1 tačka (h) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03 / L-040, član 72 Statuta opštine Drenas (Glogovac), predsjednik opštine Drenas (Glogovac), predlaže: da se na osnovu odredbi član 12, stav 12.2, tačka d, odredbe člana 17, stav 17.1, tačka j Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi, odredbe člana 18 stav 3 u vezi sa članom 45 stav 1 i 2 Zakon br. 04 / L-125 o zdravstvu, Administrativno uputstvo 04/2020 Primarna zdravstvena zaštita, odredbe člana 34.6 podtačka f Statuta opštine Glogovac usvojene 2008. godine, Skupština opštine Drenas (Glogovac), na sastanku održanom dana _____ 2021, odobreno:
STATUTIN E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “DR. HAFIR SHALA” DRENAS Neni 1 I - Dispozitat e përgjithshme	STATUTE OF THE MAIN FAMILY MEDICINE CENTER “Dr.Hafir Shala” GLLOGOC Article 1 I – General provisions	STATUT GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE Dr.Hafir Shala” GLLOGOC Član 1 I - Opšte odredbe

Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparencja në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Hafir Shala” Drenas (në tekstin e mëtejme: QKMF).	This Statute regulates: general provisions, designation and headquarter, activity of MFMC, legal status, representation and presentation, structure of the institution, leadership and bodies of the institution, continuous institutional development, supervision of MFMC, general acts of MFMC, ownership and financing, transparency at work, professional and business confidence, trade union organization, internal supervision and transitional and final provisions relating to the exercise of healthcare activity in the Main Family Medicine Center “Dr.Hafir Shala” Drenas (hereinafter: MFMC).	Ovim Statutom se ureduju: opšte odredbe, naziv i sedište, delovanje GCPM-a, pravni status, zastupanje i prikazivanje, struktura institucije, rukovodstvo i tela institucije, kontinuirani institucionalni razvoj, nadzor GCPM-a, opšti akti GCPM-a, vlasništvo i finansiranje, transparentnost u radu, profesionalna i poslovna poverljivost, sindikalno organizovanje, unutrašnji nadzor i prelazne i konačne odredbe u vezi sa sprovođenjem delatnosti primarne nege u Glavnom centru porodične medicine “Dr.Hafir Shala” Drenas –Glogovac (u daljnjem tekstu: GCPM).
Neni 2 Statusi i QKMF 1.QKMF-ja ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik në Komunen e Drenasit (në tekstin e mëtejme: KPSH). 2.Themelues i QKMF-së është Kuvendi Komunal i Komunës së Drenasit. 3.QKMF-ja në Drenas ka filluar punën në vitin 1959, fillimisht si “Shtëpi e Shëndetit”.	Article 2 MFMC Status 1.The MFMC has the status of a public legal entity, having the quality of the employing authority, where the Public Primary Healthcare is organized, provided and implemented in Municipality of Drenas (hereinafter: PHC). 2.The founder of the MFMC is the Municipal Assembly of Municipality Glogoc. 3.The MFMC in Glogoc started working in 1959. Originally as “Health House”.	Član 2 Status GCPM 1.GCPM ima status javnog pravnog lica, u svojstvu autoriteta poslodavca, gde se organizuje, pruža i primenjuje Javna Primarna zdravstvena nega u Opštinu Drenas –Glogovac (u daljnjem tekstu: PZN). 2.Osnivač GCPM je Skupština opštine Glogovac. 3.GCPM u opštinu Glogovac je počeo sa radom u 1959 godine sanazivom “Dom Zdravlje”.

II - Emërtimi dhe Selia Neni 3 Emërtimi 1. Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare” Dr. Hafir Shala” në Drenas. 2. Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës dhe aprovohet nga Kuvendi Komunal, në bazë të procedurave ligjore. 3. Emërtimi i QKMF, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të institucionit shëndetësor përkatës të KPSh. 4. Për ndryshimin e selisë së QKMF vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë. Neni 4 Selia Selia e QKMF “Dr. Hafir Shala” në Drenas gjendet në Krugën “Xhevat Demaku” Nr.74 në Drenas.	II - Designation and Headquarter Article 3 Designation 1. The name of the institution is: Main Family Medicine Center in “Dr. Hafir Shala” Drenas. 2. The recognition mark of this institution is unique for all MFMC in the Republic of Kosovo and is approved by the Municipal Assembly, on the basis of legal procedures. 3. The name of MFMC, FMC and FMA should be clearly indicated at the entrance of the respective health institution of PHC. 4. Changing of the MFMC headquarter shall be decided by the founder, upon obtaining the consent of the Ministry of Health. Article 4 Headquarter The MFMC headquarters in Municipality Drenas (Gillogoc) is located at road “Xhevat Demaku” Number 74 Drenas (Gillogoc).	II – Naziv i Sedište Član 3 Naziv 1. Naziv institucije je: Glavni Centar Porodične Medicine „Dr. Hafir Shala” u Drenas. 2. Identifikacioni znak ove ustanove je jedinstven za sve GCPM u Republici Kosovo i usvaja se od Skupštine opštine, na osnovu pravnih procedura. 3. Naziv GCPM-a, CPM-a i APM-a mora biti jasno nadpisan na ulazu dotične zdravstvene ustanove PZN-a. 4. Za promenu sedišta GCPM-a odlučuje osnivač, nakon dobijanja pristanka od Ministarstva zdravstva. Član 4 Sedište Sedište GCPM-a Opština Drenas (Glogovac) se nalazi u ulicu “Xhevat Demaku” broj.74 Gillogovac.
---	--	--

Neni 5 Vula	Article 5 Stamp	Član 5 Pečat
1.QKMF posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. 2.Vula është në formë të rumbullakët dhe ka dimension 3.5 cm (35 mm). 2.1. Rrethi i parë: Republika e Kosovës; 2.2. Rrethi i dytë: Komuna Drenas; 2.3. Rrethi i tretë: QKMF “Dr Hafir Shala” Drenas; 2.4. Në mes të vulës është logoja unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës. 3.QKMF posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x 3 cm, që përmban emërtimin, selinë dhe hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentit. 4.Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në Kosovë. 5.Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos drejtori. 6. Çdo vulë ka numër identifikues.	1.MFMC possesses its stamp, which in the legal circulation is presented as the Main Family Medicine Center. 2.The stamp is of round shape and has a dimension of 3.5 cm (35 mm). 2.1. First circle: Republic of Kosovo; 2.2. Second circle: Municipality of Drenas (Glogoc) 2.3. Third circle: MFMC in ,Dr.Hafir Shala”Drenas (Glogoc). 2.4. In the middle of the stamp stands the unique logo for all MFMCs in the Republic of Kosovo. 3.MFMC possesses the square stamp, of dimensions 5.5 cm x 3 cm, which contains the name, headquarter and space for recording the number and date of the receipt of document. 4.The stamp must contain the designation of the institution and according to this Statute must be in the languages, which are in official use in Kosovo. 5.The number of stamps, the manner of using the stamp and authorizing of persons for using and preserving the stamp shall be decided by the director. 6. Each stamp has an identification number.	1.GCPM ima svoj pečat koji se u pravnom protoku predstavlja kao Glavni centar porodične medicine. 2.Pečat je okruglog oblika i dimenzija 3.5 cm (35 mm). 2.1. Prvi krug: Republika Kosovo; 2.2. Drugi krug: Opština Drenas (Glogovac) 2.3. Treći krug: GCPM ,Dr. Hafir Shala”Drenas (Glogovac) 2.4. Na sredini pečata je jedinstveni logo za sve GCPM-ove u Republici Kosovo. 3.GCPM ima četvrtasti pečat, sa dimenzijama 5.5 cm x 3 cm., koji sadrži naziv, sedište i površinu za evidentiranje broja i datuma prijema dokumenta. 4.Pečat treba da sadrži naziv institucije, prema ovom Statutu, i da bude na jezicima koji su u službenoj upotrebi na Kosovu. 5.O broju pečata, načinu korišćenja i o ovlašćenom licu za korišćenje i čuvanje odlučuje direktor. 6. Svaki pečat ima identifikacioni broj.

III-Veprimtaria, Shërbimet dhe Përfaqësimi i QKMF Neni 6 Veprimtaria	III-Activity, Services and Representation of MFMC Article 6 Activity	III-Delatnost, usluge i zastupanje GCPM Član 6 Delatnost
1.Veprimtaria e QKMF përfshinë ofrimin e shërbimeve shëndetësore në KPSH për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës. 2.Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Drenasit t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe në vazhdimësi individit dhe familjes në të gjitha fazat e jetës, bazuar në të dhëna shkencore, përmes mjekut familjar si mjek i përgjegjedhur i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese për specialistët konsulentët në KPSH dhe në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor. 3.Sipas SSSH 2017-2021 dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermierë familjarë ofron shërbime shëndetësore për 2000 banorë	1.The activity of MFMC includes the provision of health services in PHC for the population of the municipality, as an activity of special interest, through the implementation of the concept of family medicine, within the unique health system of Kosovo. 2.The concept of family medicine consists in provision of comprehensive, efficient health services to all residents of the Municipality of Gllogoc and in continuation to individuals and families at all stages of life, on the basis of scientific data, through the family doctor as appointed doctor who will be the gateway for all service seekers in the health system and, at the same time, a reference point for specialist consultants in the PHC and other levels of health care. 3.According to HSS 2017-2021 and standards set by the Ministry of Health, the family medicine team consisting of a family doctor and two family medicine nurses provides health services for 2000 inhabitants	1.Delatnost GCPM-a obuhvata pružanje primarnih zdravstvenih usluga u PZN-u za stanovništvo opštine, kao delatnost od posebnog interesa, kroz primenu koncepta porodične medicine, u okviru jedinstvenog zdravstvenog sistema Kosova. 2.Koncept porodične medicine se sastoji u tome da se svim stanovnicima opštine Gllogovac pružaju sveobuhvatne i efikasne zdravstvene usluge, u kontinuitetu, pojedincu i porodici u svim životnim etapama, na osnovu naučnih podataka, kroz određivanje porodičnog lekara, koji će biti ulazna kapija za sve one koji zahtevaju usluge u zdravstvenom sistemu, i istovremeno referentna tačka za savetnike specialiste u PZN-u i na ostalim nivoima zdravstvene nege. 3.Prema SZS-u 2017-2021, i standarda određenih od Ministarstva zdravstva, ekipa porodične medicine koja se sastoji od jednog porodičnog lekara i dve porodične medicinske sestre pruža zdravstvene usluge za 2000 stanovnika u zavisnosti od

sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF. 4.Standardet në mjekësinë familjare sipas këtij statuti, do t'i nënshtrohen revidimit periodik nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. 5.Shërbimet shëndetësore në QKMF në Drenas, sigurohen dhe zbatohen nga profesionistët shëndetësor të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në Ligjin për Shëndetësi: 5.1. Specialist i Mjekësisë Familjare; 5.2. Doktor i Mjekësisë; 5.3. Doktor i Stomatologjisë; 5.4.Specialist i pedodoncisë dhe preventivës; 5.5. Farmacist i diplomuar – magjistr i farmacisë; 5.6. Specialist i Biokimisë klinike; 5.7. Infermier i/e diplomuar; 5.8. Mami e diplomuar; 5.9. Teknik laborant; 5.10. Teknik i farmacisë; 5.11. Teknik/asistent i stomatologjisë; 5.12. Radiologu dhe tekniku i radiologjisë në institucionet ku funksionon kabineti i Rtg; 5.13. Profesionistët shëndetësorë të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të	according to the territorial, geographical area extent and organization of MFMC. 4.According to this statute the standards in family medicine will be subject to periodic review by the Ministry of Health 5.Health services in the MFMC in .Dr.Hafir Shala'municipality Drenas (Glogoc) are provided and implemented by health professionals who meet the criteria set out in the Law on Health: 5.1.Family Medicine Specialist; 5.2.Doctor of medicine; 5.3.Doctor of dentistry; 5.4.Specialist of pedodontology and preventive; 5.5.Graduated Pharmacist–Master of pharmacy; 5.6.Specialist in Clinical Biochemistry; 5.7.Graduated nurse; 5.8.Graduated midwife; 5.9.Laboratory technician; 5.10.Pharmacy technician; 5.11. Dentistry technician / assistant 5.12. Radiologist and radiology technician in the institutions where the Rtg cabinet is operational; 5.13.Medical professionals with a middle or high education, as defined in	teritorialnog i geografskog prostiranja kao i organizovanja GCPM-a. 4.Standardi porodične medicine prema ovom statutu će se podvrgavati periodičnom revidiranju od strane Ministarstva zdravstva. 5.Zdravstvene usluge u GCPM- Opština Drenas (Glogovac) se obezbeđuju i primenjuju od zdravstvenih profesionalaca koji ispunjavaju kriterijume predviđene Zakonom o zdravstvu: 5.1 Specijalista porodične medicine; 5.2. Zdravstveni lekar; 5.3. Lekar stomatologije; 5.4.Specijalista na pedodoncia i preventiva; 5.5.Diplomirani farmaceut– magistar farmacije; 5.6. Specijalista kliničke biohemije; 5.7. Diplomirani/a medicinska sestra; 5.8. Diplomirana akušerka; 5.9. Laboratorijski tehničar; 5.10. Farmaceutski tehničar; 5.11. Tehničar/asistent stomatologije; 5.12. Radiolog i radiološki tehničar u ustanovi gde funkcioniše Rtg kabinet; 5.13.Ostali zdravstveni stručnjaci sa srednjim i visokim kvalifikacijama,
---	---	--

përcaktuar në regjistrin zyrtar të Ministrisë; 5.14. Bashkëpunëtorët profesional me shkolim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve sipas Ligjit të Shëndetësisë.	the official register of the Ministry of Health; 5.14. Other professional associates with non-medical education, registered in the official register by the decision of the Minister of Health, at the proposal of the respective Chamber of Health Professionals according to the Law on Health.	određenim u službenom registru Ministarstva; 5.14. Stručni saradnici sa školovanjem van oblasti zdravstva, evidentirani u službenom registru odlukom Ministarstva zdravstva, na osnovu predloga dotične Komore stručnjaka po Zakonu o zdravstvu.
6. Në QKMF në Drenas funksionon materniteti dhe është i domosdoshëm Gjinekologu dhe Neonatologu ose Pediatri.	6. In a MFMC where maternity ward operates, a Gynecologist and Neonatologist or Pediatrician are required.	6. U GCPM-u, gde funkcioniše materinstvo, neophodan je ginekolog i neonatolog ili pedijatar.
7. Specialistët ekzistues nga lëmitë e tjera, mund të vazhdojnë punën në KPSH si konsulent të Mjekëve Familjarë deri në pensionim.	7. Specialists of other fields can continue working in the PHC as a family doctor consultant until retirement.	7. Specijalisti iz ostalih oblasti mogu da nastave rad u PZN-u kao konsultanti porodičnih lekara do penzionisanja.
8. Konsulentët në KPSH sipas paragrafit 3 të këtij Neni ofrojnë shërbime konsultative në QKMF dhe QMF.	8. According to paragraph 3 of this Article, consultants in PHC provide consulting services in the MFMC and FMC.	8. Konsultant u PZN-u po stavki 3. ovog člana pružaju konsultativne usluge u GCPM-u i CPM-u.
9. Mjeku familjarë duhet të jetë i certifikuar për të ofruar shërbime me Ultrazë.	9. The family doctor must be certified to provide Ultrasound services.	9. Porodični lekar mora biti sertifikovan da bi pružao usluge ultrazvukom.

Neni 7 Shërbimet	Article 7 Services	Član 7 Usluge
1.QKMF kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor: 1.1.Shërbimet e promovimit shëndetësor; përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet; 1.2.Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese; 1.3.Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike; 1.4.Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent; 1.5.Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike; 1.6.Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinj; 1.7.Shërbimet e shëndetit riprodhues; 1.8.Shërbimet e shëndetit oral dhe parandalues; 1.9.Shërbimet e shëndetit mendor; 1.10.Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijes, kujdesi paliativ si dhe kujdesi shtëpiak bazuar në nevojat e popullatës dhe prioritetet e shëndetit publik;	1.MFMC provides the following primary healthcare services: 1.1.Health promotion services, including information, communication and education within institutions and in the community; 1.2.Immunization and vaccination services as well as other preventive services; 1.3.Essential curative services and minor surgical interventions; 1.4.Acute and emergency healthcare services; 1.5.Healthcare services for chronic diseases; 1.6.Healthcare services for children, adolescents and young people; 1.7.Reproductive health-care services; 1.8.Oral and preventive health services; 1.9.Mental health services; 1.10.Home healthcare services including maternal and child care services, palliative care as well as home healthcare on the basis of the needs of population and public health priorities;	1.GCPM obavlja ove usluge primarne zdravstvene nege: 1.1.Usluge zdravstvenog promovisanja, uključujući informisanje, komunikaciju i obrazovanje unutar ustanova i u zajednici; 1.2.Usluge imunizacije i vakcinacije i ostale preventivne usluge; 1.3.Esencijalne usluge lečenja i male hirurške intervencije; 1.4.Usluge akutne i hitne nege; 1.5.Usluge zdravstvene nege za hronične bolesti; 1.6.Usluge zdravstvene nege za decu, adolescente i mlade; 1.7.Usluge reproduktivnog zdravlja; 1.8.Usluge oralnog i preventivnog zdravlja; 1.9.Usluge mentalnog zdravlja; 1.10.Usluge kućne nege uključujući usluge nege prema majki i detetu, palijativna nega kao i kućna nega na osnovu potrebe stanovništva i prioriteta javnog zdravlja;

1.11.Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale.	Neni 8 Përfaqësimi	1.QKMF në Drenas është institucion, i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor publik në Republikën e Kosovës. 2.QKMF kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi. 3.Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet kapitale, me ose pa vlerë rigjeneruese të QKMF, duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF dhe aprovimin e themeluesit, në bazë të ligjeve në fuqi. 4.Drejtori i QKMF ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF me pëlqim të Drejtoratit Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.	1.11. Distribution of medicaments from the essential list. Article 8 Representation	1.MFMC in Municipality Glogoc is an institution, which is part of the network of public Primary Healthcare institutions in the Republic of Kosovo. 2.MFMC carries out and provides primary healthcare services for the citizens of the municipality, pursuant to the legal provisions in force. 3.For the signing of contracts, whereby are acquired, alienated or sold MFMC capital buildings and equipment, with or without regeneration value, first there is required a proposal by the management of the MFMC and the approval by the founder, based on the laws in force. 4.The Director of MFMC has all the authorizations for legal and business representation, within the activity of MFMC upon the consent of the Municipal Directorate of Health and Social Welfare.	1.11. Raspodela lekova sa esencijalne liste. Član 8 Zastupanje	1.GCPM u Opštinu Glogovac je institucija, koja je deo mreže javnih institucija Primarne zdravstvene nege, u Republici Kosova. 2.GCPM obavlja i pruža usluge primarne nege za građane opštine, prema zakonskim odredbama na snazi. 3.Za potpisivanje ugovora, kojima se stiču, otuđuju ili prodaju objekti i kapitalna oprema, sa ili bez regenerativne vrednosti GCPM-a, potreban je prvo predlog rukovodstva GCPM-a i saglasnost osnivača, na osnovu zakona na snazi. 4.Direktor GCPM ima sva ovlašćenja za pravno i poslovno zastupanje, unutar delatnosti GCPM uz saglasnost Opštinske Direkcije za zdravstvo i socijalnu zaštitu.
---	--	---	--	--	---	---

IV-Struktura e Institucionit në QKMF	IV-Institution Structure in the MFMC	IV-Struktura institucije u GCPM-u.
Neni 9 Organizimi i QKMF	Article 9 Organization of the MFMC	Član 9 Organizovanje u GCPM
1.QKMF me qëllim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore për banorët e vet, organizohet me këto njësi përbërëse: 1.1.Departmenti i Mjekësisë Familjare me këtë përbërje: 1.1.1.Sektori i Mjekësisë Familjare; 1.1.2.Njësia e SISH; 1.1.3.Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit; 1.1.4.Sektori i Shëndetit Oral Preventiv; 1.1.5.Sektori i Kujdesit Urgjent; 1.1.6.Sektori konsultativ dhe diagnostikë; 1.1.6.1. Sherbimet konsultative; 1.1.6.2 Kabineti Radiologjik; 1.1.6.3.Laboratori. 1.2.Departmenti i Administratës së QKMF në Drenas organizohet në: 1.2.1. Njësia ose Zyra e Personelit; 1.2.2. Njësia ose Zyra Juridike; 1.2.3. Njësia ose Zyra për buxhet dhe financa;	1.In order to provide healthcare for its residents, the MFMC is organized into the following constituent units: 1.1.Department of Family Medicine consisting of: 1.1.1.Family Medicine Sector; 1.1.2.HIS Unit; 1.1.3 Vaccination and Immunization Unit; 1.1.4 Oral Health Preventive Sector; 1.1.5 Emergency Healthcare Sector; 1.1.6 Consulting and Diagnostics Sector; 1.1.6.1. Consulting services; 1.1.6.2 Radiology Cabinet; 1.1.6.3.Laboratory. 1.2.The Administration Department of the MFMC ,Dr. Hafir Shala’Municipality Gllgoc consists of: 1.2.1. Human Resources Unit or Office; 1.2.2. Legal Unit or Office; 1.2.3. Budget and Finance Unit or Office;	1.GCPM, u cili pružanje zdravstvene nege za svoje stanovnike, organizuje se sastavnim jedinicama: 1.1.Odeljenje porodične medicine u ovom sastavu: 1.1.1.Sektor porodične medicine; 1.1.2.Jedinica ISZ-a; 1.1.3Jedinica vakcinacije i imunizacije, 1.1.4Sektor preventivnog oralnog zdravlja; 1.1.5.Sektor hitne nege; 1.1.6 Sektor za konsultaciju i Dijagnostika; 1.1.6.1. Konsultativne usluge; 1.1.6.2. Radiološki kabinet; 1.1.6.3.Laboratorija. 1.2.Odeljenje Administracije GCPM-a u .Dr.Hafir Shala’ Opština Glogovac organizuje se u: 1.2.1. Jedinica ili Kancelarija osoblja; 1.2.2. Jedinica ili Pravna kancelarija; 1.2.3. Jedinica ili Kancelarija za budžet i finansije;

1.2.4. Njësia ose Zyra e prokurimit; 1.2.5. Njësia ose Zyra për shërbime teknike. 1.3. Barnatorja Qendrore: 1.3.1. Barnatorja qendrore është njësi organizative e QKMF e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike; 1.3.2. Në QMF / AMF funksionojnë barnoret doracake të cilat menaxhohen, furnizohen dhe monitorohen nga barnatorja Qendrore në QKMF; 1.3.3. Nga barnatorja qendrore dhe njësia e saja në QMF/AMF shpërndahen vetëm barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria dhe të përshkruara në recetat unike , nga Mjekët e Sektorit të Mjekësisë Familjare; 1.3.4. Me barnatoren qendrore udhëheq Shefi i Barnatores. 1.4. Materniteti funksionon si në paragrafin 6 të nenit 6, të këtij statuti. 2. Lista e Qendrave të Mjekësisë Familjare QMF (Drenas dhe Komoran) dhe	1.2.4. Procurement Unit or Office; 1.2.5. Technical Services Unit or Office. 1.3. Central Pharmacy: 1.3.1. The central pharmacy is an organizational unit of MFMC which is established and operates according to the laws and sub-legal acts that regulate the pharmaceutical activity; 1.3.2. Within FMC /FMA operate manual pharmacies which are managed, supplied and monitored by the central pharmacy in MFMC; 1.3.3. The central pharmacy and its units in FMC /FMA distribute only the drugs from the Essential List of Medicines, allowed by the Ministry, and prescribed in unique prescriptions, by the Doctors of the Family Medicine Sector; 1.3.4. The central pharmacy is managed by the Chief Pharmacist. 1.4. Maternity is functioning as in paragraph 6 of article 6 of this statute. 2. The list of Family Medicine Centers - FMC -Drenas(Gillogoc), Komoran FMA -(Arllat,	1.2.4. Jedinica ili Kancelarija osoblja; 1.2.5. Jedinica ili Kancelarija za tehničke usluge. 1.3. Centralna apoteka: 1.3.1. Centralna apoteka je organizaciona jedinica GCPM-a koja se osniva i funkcioniše prema zakonima i podzakonskim aktima koji uređuju farmaceutsku delatnost; 1.3.2. U CPM-u / AMF-u rade priručne apoteke koje se rukovode, snabdevaju i nadgledaju od centralne apoteke u GCPM-u; 1.3.3. Iz centralne apoteke i njenih jedinica pri CPM-u/APM-u mogu da se raspodele samo lekovi sa Esencijalne liste lekova, dozvoljene od Ministarstva, i propisanih u jedinstvenim receptima, od lekara Sektora porodične medicine; 1.3.4. Centralnu apoteku vodi šef apoteke. 1.4. Materinstvo funkcioniše kao u stavu 6. člana 6. ovog statuta. 2. Lista Centara porodične medicine-CPM-Drenas (Glogovac), Komorane i Ambulanti
---	---	---

Ambulancave të Mjekësisë Familjare – AMF (Arllat, Nekoc, Sankoc, Gllanasellë, Dobroshec, Poklek-Vasilevë, Gradicë, Terstenik, Baicë, Terdec dhe Abri) në kuadër të QKMF-së Drenas përbënë Rrjetin e institucioneve të KPSH në Komunën e Drenasit. 3.Rrjeti i Institucioneve shëndetësore sipas paragrafit 5 do të jetë objekt i revidimit periodik që do të ndërmerret nga KK i Komunës Drenas me pëlqim të Ministrisë së Shëndetësisë.	Nekoc, Sankoc, Gllanasellë, Dobroshec, Gradicë, Terstenik, Baica, Terdec and Abri) constitutes the Network of CSP institutions in the Municipality of Gllagoc. 3.The network of health institutions according to paragraph 5 will be subject to periodic review which shall be undertaken by the MA Municipality Drenas upon the consent by the Ministry of Health.	poroçine medicine – APM(Arllat,Nekovac,Sankovac,Vasilevo,GI anasello,Dobroshec,Gradica,Terstenik,Baica, Abria) u okviru GCPM-a u Opštini Drenas sačinjava mrežu institucija PZN. 3.Mreža zdravstvenih ustanova prema stavu 5. će biti predmet periodičnog revidiranja koje će se preduzeti od SO Drenas uz saglasnost Ministarstva zdravstva.
Neni 10 Sistemi i Informimit Shëndetësor në QKMF 1.QKMF në Drenas zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor, ashtu siç është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi. 2.Departmenti i SISH në Ministrinë e Shëndetësisë në koordinim me QKMF bënë implementimin e Sistemit dhe funksionalizimin e tij në të gjitha nivelet e institucioneve të KPSH-së.	Article 10 Health Information System in the MFMC 1.MFMC ,Dr.Hafir Shala”in Municipality Drenas (Gllagoc) implements the unique health information system, as provided by the Law on Health and sub-legal acts regulating this field. 2.The HIS Department in the Ministry of Health in coordination with the MFMC carries out the implementation of the System and its functioning at all levels of PHC institutions.	Član 10 Sistem zdravstvenog informisanja u GCPM-u 1.GCPM ,Dr.Hafir Shala”u Drenas (Glogovac) primenjuje jedinstveni sistem zdravstvenog informisanja, kao što je predviđeno Zakonom o Zdravstvu i podzakonskim aktima koji uređuju ovu oblast. 2.Department ISZ-a pri Ministarstvu Zdravlja u koordinaciji sa GCPM-om vrši implementaciju sistema i njegovu funkcionalizaciju na svim nivoima ustanova IZS-a.

3.QKMF obligohet të përdorë sistemin Informativ Shëndetësor nga MSh për të gjitha llojet e shërbimeve të ofruara duke përfshirë edhe bashkëpagesat. 4.Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale çdo profesionist shëndetësor obligohet që të ruaj konfidencialitetin e të dhënave për të gjitha veprimet e ndërmarra me Sistemin e Informimit Shëndetësor.	3.MFMC is obliged to use the Health Information System by the MoH for all types of provided services, including co-payments. 4.Pursuant to the law on the protection of personal data, every health professional is obliged to maintain the confidentiality of data for all actions taken within the Health Information System.	3.GCPM se obavezuje da koristi Informativni zdravstveni sistem od MZ-a sa sve vrste pruženih usluga uključujući i doplate. 4.Primenom zakona za zaštitu ličnih podataka, svaki zdravstveni stručnjak je dužan da čuva poverljivost podataka za sve preduzete radnje u Informativnom zdravstvenom sistemu.
V-Udhëheqja dhe trupat e QKMF Neni 11 Këshilli Drejtues, Struktura 1.Këshilli Drejtues ka 7 anëtarë: 1.1.Drejtori i QKMF, i cili e kryeson Këshillin; 1.2.Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare; 1.3.Kryeinfermieri/ja i/c QKMF; 1.4.Udhëheqësi i Departamentit të Administratës; 1.5.Koordinatori për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore; 1.6.Përfaqësuesi i sindikatës në cilësinë e vëzhguesit;	V-MFMC administration and bodies Article 11 Board of Directors, Structure 1.The Board of Directors consists of 7 members: 1.1. Director of MFMC, who chairs the Board; 1.2.Head of Family Medicine Department; 1.3.MFMC Head Nurse; 1.4.Head of Administration Department; 1.5.Coordinator for improving the quality of health services; 1.6.Trade Union representative in the capacity of the observer;	V-Upravljanje i tela GCPM-a Član 11 Upravni savet, struktura 1.Upravni savet ima 7 članova: 1.1.Direktor GCPM-a, koji upravlja Savetom; 1.2.Rukovodilac Odeljenja porodične medicine; 1.3.Glavna medicinska sestra GCPM-a; 1.4.Rukovodilac Odeljenja administracije; 1.5.Koordinator za povećanje kvaliteta zdravstvenih usluga; 1.6.Predstavnik administracije u svojstvu posmatrača;

1.7.Përfaqësues nga Këshilli i pacientëve. 2.Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat sa edhe kontrata e punës së tyre, por mund të përfundojë edhe më parë në rastet kur: 2.1.Anëtar i ndërprenë marrëdhënien e punës në QKMF; 2.2.Anëtar i Këshillit Drejtues jep dorëheqje; 2.3.Anëtar i Këshillit Drejtues mungon pa arsye në mbledhje të Këshillit, brenda vitit, tri herë radhazi; 2.4.Anëtar i nuk respekton detyrat e punës.	1.7.Representatives from the Patient Council. 2.The mandate of the members of the Board of Directors shall last throughout the term of their employment contract, but may end even earlier in cases when: 2.1.The member terminates his employment relationship with the MFMC; 2.2.The member of the Board of Directors resigns; 2.3.The member of the Board of Directors is absent without justification from the meetings of the Board, three times in a row, within the year; 2.4.The member does not respect the job duties.	1.7.Zastupljenost saveta pacijenata. 2.Mandat članova Upravnog saveta traje koliko i njihov radni ugovor, ali može da se završi i ranije u slučajevima kada: 2.1. Član prekida radni odnos pri GCPM-om; 2.2. Član Upravnog saveta daje ostavku; 2.3.Član Upravnog saveta bez razloga odsustvuje na sastancima Saveta, unutar jedne godine, tri puta uzastopno; 2.4.Član ne poštuje radne zadatke.
Neni 12 Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Drejtues 1.Këshilli Drejtues kryen detyrat të përcaktuara me këtë Statut dhe vendos për: 1.1.Veprimtarinë e QKMF dhe vërteton politikën punuese të QKMF; 1.2.Propozon ndryshimet e Statutit të QKMF përmes DShMS, të cilat propozime pas dhënies së pëlqimit nga	Article 12 Competencies and Duties of the Board of Directors 1.The Board of Directors performs the duties defined by this Statute and decides on: 1.1.The activity of MFMC and confirms the working policy of MFMC; 1.2.Proposes amendments to the Statute of MFMC through DHSW, which proposals following the consent by the Ministry of Health, are approved by the Municipal Assembly;	Član 12 Ovlašćenja i zadaci Upravnog saveta 1.Upravni Savet obavlja zadatke određenih ovim Statutom i odlučuje o: 1.1.Delatnosti GCPM i utvrđuje radnu politiku GCPM-a; 1.2.Predlaže izmene Statuta GCPM-a preko DZSZ-a, koje predloge nakon davanja saglasnosti od strane

ana e Minsitit të Shëndetësisë, i aprovon Kuvendi Komunal; 1.3. Aprovon raportin e punës dhe llogaritë vjetore të QKMF dhe raportin në Divizionin e Kujdesit Parësor Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë përmes Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. 1.4. Vendosi për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit; 1.5. Përgatitë programin e punës dhe planin financiar; 1.6. Harton rregulloren për organizimin e punës në QKMF dhe aktet tjera në përputhshmëri me ligjin dhe me këtë Statut; 1.7. Harton planin e burimeve njëzëre sipas propozimit të Këshillit Profesional brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikën e MSh; 1.8. Miraton planin vjetor për ZhVP të kuadrit mjekësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij; 1.9. Bënë planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë; 1.10. Emëron komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese; 1.11. Vendosi për sigurimin e pasurisë së QKMF, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit;	1.3. Approves the work report and annual financial accounts of the MFMC and reports to the Primary Health Care Division at the Ministry of Health through the Municipal Directorate of Health and Social Welfare. 1.4. Decides on the use of funds within the scope of the law; 1.5. Prepares work program and financial plan; 1.6. Drafts the regulation on the organization of work at the MFMC and other acts in accordance with the law and this Statute; 1.7. Drafts the human resources plan according to the proposal of the Professional Council within the available resources and in accordance with the policies of the MoH; 1.8. Approves the annual CPD plan of medical staff and health associates and ensures its application; 1.9. Prepares the plan and program of measures for protection at work; 1.10. Appoints interim commissions and other working bodies; 1.11. Decides on the insurance of MFMC property, employees' insurance in accordance with the law; 1.12. Proposes the construction and adaptation of facilities, as well as the	Ministarstva Zdravlja, usvaja Skupština opštine; 1.3. Usvaja radni izveštaj i godišnje račune GCPM-a i izveštava pri Diviziji primarne zdravstvene nege u Ministarstvu zdravstva kroz Opštinsku Direkciju za zdravstvo i socijalnu zaštitu. 1.4. Odlučuje o korišćenju sredstava u okviru zakona; 1.5. Priprema program rada i finansijski plan; 1.6. Izrađuje pravilnik o organizaciji rada pri GCPM-u i ostale akte u skladu sa zakonom i ovim Statutom; 1.7. Izrađuje plan ljudskih resursa po predlogu Profesionalnog saveta unutar raspoloživih resursa i u skladu sa politikama MZ; 1.8. Izrađuje plan o KPR lekarskog osoblja i zdravstvenih saradnika i obezbeđuje njegovu primenu; 1.9. Izrađuje plan i program mera za zaštitu na radu; 1.10. Imenuje privremene komisije i ostale radne organe; 1.11. Odlučuje o osiguranju imovine GCPM-a, osiguranje radnika na osnovu zakona; 1.12. Predlaže izgradnju i adaptiranje objekata, kao i o izvorima sredstava za
--	--	---

1.1.2.Propozon ndërtimin dhe adaptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar në politikën shëndetësore të MSh; 1.13.Kryen edhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetencë, me këtë statut dhe aktet tjera normative të QKMF. 2.Këshilli Drejtues i QKMF i kryen detyrat brenda përgjegjësi të veta në takime. 3.Këshilli Drejtues mban takime të rregullta në të cilat marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve. 4.Këshilli Drejtues merr vendime me shumicë të votave të anëtarëve të zgjedhur. 5.Në takimet e Këshillit Drejtues mbahet procesverbal, të cilin e aprovojnë pjesëmarrësit në takimin vijues. 6.Këshilli i pacientëve: 6.1.Përfaqëson interesat e pacientëve në Institucionet e KPSH-së; 6.2.Organizon pacientët për të mbështetur institucionin në ofrimin e kujdesit shëndetësor;	sources of funds for the performance of these works on the basis of the health policy of the MoH; 1.13.Performs other tasks which pertain to its competence, according to this statute and other normative acts of MFMC. 2.The Board of Directors of MFMC carries out its duties within its responsibilities in meetings. 3.The Board of Directors holds regular meetings which are attended by more than the half of the members; 4.The Board of Directors takes decisions by a majority vote of the elected members. 5.In the meetings of the Board of Directors are kept minutes that are approved by the participants in the subsequent meeting. 6.The Patient Council: 6.1. Represents the interests of patients in PHC institutions; 6.2. Organizes patients to support the institution in providing health care;	obavljanje ovih radova na osnovu zdravstvenih politika MZ-a; 1.13.Obavlja i druge zadatke koja su mu ostavljene u nadležnosti ovim Statutom i ostalim normativnim aktima GCPM-a. 2.Upravni savet GCPM obavlja zadatke unutar njegovih odgovornosti na sastancima. 3.Upravni savet održava redovne sastanke na kojima učestvuju više od polovine članova; 4.Upravni savet donosi odluke većinom glasova izabranih članova. 5.Na sastancima Upravnog saveta se vodi zapisnik, kojeg usvajaju učesnici na narednom sastanku. 6. Savet pacijenata 6.1.Zastupa interese pacijenata u institucijama PZZ; 6.2.Organizuje pacijente da podrže ustanovu u pružanju zdravstvene zaštite; 6.3.Uspostavlja mehanizme komunikacije između Ministarstva zdravlja i pacijenata.
--	--	--

6.3 Krijon mekanizmat e komunikimit midis MSh dhe pacienëve.	6.3. List Patients Council, represents patients' interests and helps to improve the quality of health care.	
Neni 13 Drejtori i QKMF 1.QKMF e udhëheq Drejtori i QKMF.	Article 13 Director of the MFMC 1.The MFMC is administered by the Director of MFMC.	Član 13 Direktor GCPM 1. GCPM-om upravlja direktor GCPM-a.
2.Drejtori përfaqëson, prezanton QKMF dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe ligjshmërinë e punës.	2.The Director represents, represents the MFMC and is responsible for the management and legality of the work.	2. Direktor zastupa GCPM i odgovoran je za upravljanje i zakonitost rada.
3.Drejtori i QKMF i përgjigjet për menaxhimin mjekësor, administrativ dhe financiar të të gjitha funksioneve të shërbimeve në QKMF, Drejtorit Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.	3.The Director of MFMC is accountable for the medical, administrative and financial management of all service functions in the MFMC, to the Municipal Director of Health and Social Welfare.	3.Direktor GCPM odgovara za lekarsko, administrativno i finansijsko rukovodstvo svih funkcija usluga u GCPM, Opštinskom direktoru za zdravstvo i socijalnu zaštitu.
4.QKMF që kanë një personel mbi 100 të punësuar kanë Zëvendës drejtorin.	4.MFMCs which have a staff of over 100 employees have a Deputy Director.	4.GCPM-ovi koji imaju osoblje od preko 100 zaposlenih, imaju zamenika direktora.
5.Zëvendës drejtori ndihmon në ushtrimin e detyrave të përditshme dhe vepron në emër të drejtorit në mungesë të tij.	5.The Deputy Director assists in the exercise of day-to-day duties and acts on behalf of the Director in his absence.	5.Zamenik direktora pomaže u vršenju svakodnevnih dužnosti i deluje u ime direktora u njegovom odsustvu.
Neni 14 Procedura për emërimin e Drejtorit	Article 14 The Procedure for appointing the Director	Član 14 Postupak za imenovanje direktora

1. Drejtorin e zgjedh Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. 2. Drejtor i QKMF duhet të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit, në bazë të ligjeve në fuqi: 2.1. Të jetë Mjek specialist nga Mjekësia Familjare; 2.2. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë përvojë të dëshmuar në procesin e implementimit të mjekësisë familjare ose kandidatët me shkollim profesional në fushën e menaxhimit shëndetësor; 2.3. Kandidati për Drejtor duhet t'i ketë 5 vite përvojë pune në sistemin shëndetësor publik prej tyre 3 vite përvojë pune në pozita menaxheriale. 3. Vendimin për publikimin e konkursit për Drejtor të QKMF e merr komuna. 4. Procedurat për përzgjedhjen e Zëvendës drejtorit e udhëheqë Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.	1. The director is appointed by the Municipal Directorate for Health and Social Welfare. 2. The person to be appointed the director of MFMC should meet the general and special conditions of employment, based on the laws in force: 2.1. Should be a specialist doctor of the Family Medicine; 2.2. Candidates who have proven experience in the family medicine implementation process or candidates having professional education in the field of health management shall have an advantage; 2.3. The candidate for the position of Director must have 5 years of work experience in the public health system of which 3 years should pertain to work experience in managerial positions. 3. The decision to publish the vacancy for the position of Director of MFMC is taken by the municipality. 4. Procedures for appointing the Deputy Director are conducted by the Municipal Directorate of Health and Social Welfare	1. Direktora bira Opštinska Direkcija za zdravstvo i socijalnu zaštitu. 2. Za direktora GCPM-a treba odabrati lice koje ispunjava opšte i posebne uslove zapošljenja, na osnovu zakona na snazi: 2.1. Da je lekar specijalista Porodične medicine; 2.2. Prednost će imati kandidati koji imaju dokazano iskustvo u procesu sprovođenja porodične medicine ili kandidati sa stručnim školovanjem u oblasti zdravstvenog rukovodstva; 2.3. Kandidat za direktora treba da ima 5 godina radnog iskustva u javnom zdravstvenom sistemu od kojih 3 godine radnog iskustva u rukovodećim položajima; 3. Odluku za objavljivanje konkursa za direktora GCPM-a donosi opština. 4. Postupcima za izbor Zamenika direktora upravlja opštinska direkcija za zdravlje i socijalnu zaštitu.
---	---	---

Neni 15 Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorit të QKMF	Article 15 Competencies, duties and responsibilities of the Director of the MFMC	Član 15 Ovlašćenja, zadaci i odgovornosti direktora GCPM-a
1.Drejtori i QKMF është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF si dhe për punën profesionale të QKMF e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve të tjera normative.	1.The Director of MFMC is responsible for ensuring the legality of the work and business activity of MFMC as well as for the professional work of MFMC which must be organized and conducted in accordance with the provisions of this Statute, and other normative acts.	1.Direktor GCPM je odgovoran za obezbjeđivanje zakonitosti u radu i poslovanju GCPM-a kao i za profesionalni rad GCPM-a koja treba da se organizuje i upravlja u skladu sa odredbama ovog Statuta i ostalih normativnih akata.
2.Drejtori i QKMF është përgjegjës për përkujdesjen efektive dhe efektive të shëndetësisë parësore publike për të gjithë banorët e Komunës së Drenasit dhe përgjigjet për detyrat që vijnë:	2. The Director of MFMC is responsible for the efficient and effective public primary healthcare for all residents of the Municipality of Glogoc as well as for the following duties:	2.Direktor GCPM-a je odgovoran za efektivno i efikasno staranje o javnom primarnom zdravlju svih stanovnika opštine Glogovac i odgovoran je za sledeće zadatke:
2.1.Në pajtim me Politikën Shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125 dhe SSSH, UA per KPSH, Drejtori i QKMF i propozon për miratim, Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Planin e Punës dhe Buxhetin e QKMF për vitin vijues; 2.2.Drejtori është përgjegjës për implementimin e Planit të burimeve njerëzore;	2.1.In accordance with the Health Policy, the Law on Health No. 04 / L-125 and HSS, AI for PHC, the Director of MFMC proposes for approval to the Municipal Directorate of Health and Social Welfare the MFMC Work Plan and Budget for the incoming year; 2.2.The Director is responsible for the implementation of the Human Resources Plan;	2.1.U skladu sa Zdravstvenom politikom, Zakona o zdravstvu br. 04/L-125 i SSZ-om AU ISZ-a, direktor GCPM-a predlaže za usvajanje Opštinskoj Direkciji za zdravstvo i socijalnu zaštitu, Radni plan i budžet GCPM-a za narednu godinu; 2.2.Direktor je odgovoran za sprovođenje Plana ljudskih resursa;
		2.3.Pod nadzorom i ovlašćenjem

2.3.Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale zbaton buxhetin e QKMF; 2.4.Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF; 2.5.Avancon punën ekipore; 2.6.Mundëson Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF; 2.7.Menaxhon implementimin e standardeve të cilësisë; 2.8.Kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF. 3.Programi i punës së QKMF-së realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të hartuara nga MSH. 4.Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura në QKMF si: 4.1. Plani vjetor i punës; 4.2. Organizimi dhe udhëheqja; 4.3. Burimet njerëzore; 4.4. Plani financiar; 4.5.Raportet e punës mujore, vjetore dhe raportet financiare.	2.3.Under the supervision and authorization of the Municipal Directorate of Health and Social Welfare implements the MFMC budget; 2.4.Is responsible for the daily management of the work process in the MFMC; 2.5.Promotes the teamwork; 2.6.Enables Continuous Professional Development and training of the MFMC staff; 2.7.Manages the implementation of quality standards; 2.8.Contributes to the development and implementation of the MFMC health information system. 3.The work program of the MFMC is implemented based on the health system development policies drafted by the MoH. 4.In the annual work program must be defined the objectives, activities and expected results in the MFMC, such as: 4.1. Annual work plan; 4.2. Organization and administering; 4.3. Human Resources; 4.4. Financial Plan; 4.5.Monthly, annual work reports and financial statements.	Opštinske Direkcije za zdravstvo i socijalnu zaštitu realizuje budžet GCPM-a; 2.4.Odgovor je za svakodnevno upravljanje procesom rada u GCPM-u; 2.5.Unapređuje ekipni rad; 2.6.Omogućava kontinuirani profesionalni razvoj i obuku osoblja GCPM-a; 2.7.Rukovodi sprovođenje standarda kvaliteta; 2.8.Doprinosi razvoju sistema zdravstvenog informisanja GCPM-a. 3.Program rada GCPM-a se realizuje na osnovu razvojnih politika zdravstvenog sistema izrađenih od MZ. 4.U godišnjem programu rada treba da se određuju ciljevi, aktivnosti i očekivani rezultati u GCPM-a, kao što su: 4.1. Godišnji plan rada; 4.2. Organizovanje i upravljanje; 4.3. Ljudski resursi; 4.4. Finansijski plan; 4.5.Izveštaji mesečnog i godišnjeg rada i finansijski izveštaji.
---	---	---

5. Për kryerjen e punëve të tij, drejtori i QKMF i përgjigjet Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.	5. For the performance of his duties, the director of MFMC reports to the Municipal Directorate of Health and Social Welfare.	5. Za izvršavanje svojih poslova, direktor GCPM odgovara Opštinskoj Direkciji za zdravstvo i socijalnu zaštitu.
Neni 16 1. Drejtori ka për detyrë që, gjatë punës dhe vendimeve që i merr Këshilli Drejtues, të tërheqë vëmendjen: 1.1. Nëse aktet e propozuara janë në kundërshtim me ligjet relevante, përkatësisht, në kundërshtim me aktet e përgjithshme të QKMF; 1.2. Nëse akti i propozuar është në kundërshtim me Programin e punës së QKMF; 1.3. Nëse akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.	Article 16 1. The Director has the duty to draw attention during the work and decisions taken by the Board of Directors: 1.1. If the proposed acts are contrary to the relevant laws, respectively, contrary to the general acts of the MFMC; 1.2. If the proposed act is in conflict with the work Program of the MFMC; 1.3. If the proposed act does not contribute to the objective.	Član 16 1. Direktor ima zadatak da tokom rada i odluka koje donosi Upravni savet, skrene pažnju: 1.1. Ukoliko su predloženi akti u suprotnosti sa relevantnim zakonima, odnosno u suprotnosti sa opštim aktima GCPM-a; 1.2. Ukoliko je predloženi akt u suprotnosti sa Programom rada GCPM-a; 1.3. Ukoliko predloženi akt ne doprinosi cilju.
Neni 17 Trupat e QKMF 1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli Drejtues, përmes drejtorit të QKMF, formon Trupa Profesionale në QKMF, siç janë: 1.1. Këshilli Profesional; 1.2. Komisioni Disiplinor i QKMF; 1.3. Komisioni i Ankesave i QKMF;	Article 17 MFMC Bodies 1. For the fulfillment of special tasks, the Board of Directors, through the director of MFMC, establishes Professional Bodies in MFMC, such as: 1.1. Professional Council; 1.2. MFMC Disciplinary Commission; 1.3. MFMC Complaints Commission;	Član 17 Tela GCPM-a 1. Da bi ispunio posebne zadatke, Upravni savet, preko direktora GCPM-a, formira profesionalna tela pri GCPM-u, kao što su: 1.1. Profesionalni savet; 1.2. Disciplinska komisija GCPM-a; 1.3. Komisija za žalbe GCPM-a;

1.4.Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore; 1.5.Komisioni Etiko – Profesional. 2.Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga Drejtori i QKMF. 3.Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF, sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional në QKMF.	1.4.Committee on Quality and Safety of Health Services; 1.5.Professional Ethics Commission. 2.The members of the professional bodies are appointed by the Director of MFMC. 3.The Board of Directors, if necessary, may establish other professional bodies in the MFMC through the Director of MFMC.	1.4.Komitet za kvalitet i sigurnost zdravstvenih usluga; 1.5.Etičko – profesionalna komisija. 2.Članove stručnih tela imenuje direktor GCPM-a. 3.Upravni savet, preko direktora GCPM-a, prema potrebi, može da formira i druga profesionalna tela u GCPM-u.
Neni 18 Këshilli Profesional		
1.Këshilli Profesional është trup këshillëdhënës i Drejtorit të QKMF. 2.Këshilli Profesional përbëhet nga Udhëheqësit e Departamenteve, Udhëheqësit e Sektorëve dhe Njësite, Shefit të Barnatores qendrore si dhe Kryeinfirmieri/ja e QKMF, sipas nenit 9 të këtij Statuti. 3.Kryetar i Këshillit Profesional, sipas detyrës zyrtare, është Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare të QKMF. 4.Këshilli Profesional harton Rregulloren e punës për punën e Këshillit.	1.The Professional Council is an advisory body to the MFMC Director. The Professional Council consists of the Heads of Departments, the Heads of Sectors and Units, the Head of the Central Pharmacy and the Head Nurse of the MFMC, in accordance with article 9 of this Statut. 3.According to the official duty, the Head of the Department of Family Medicine of MFMC is the Chairman of the Professional Council. 4.The Professional Council drafts the Rules of Procedure for the work of the Board.	1.Professionalni savet je savetodavno telo direktora GCPM-a. 2.Professionalni savet se sastoji od rukovodioca Odeljenja, rukovodioca Sektora i Jedinica, šefa centralne Apoteke kao i glavne medicinske sestre GCPM-a, prema članu 9. ovog Statuta. 3.Predsednik Profesionalnog saveta, prema službenoj dužnosti, je rukovodilac Odeljenja porodične medicine GCPM-a. 4.Stručni savet izrađuje Pravilnik o radu Saveta.
Član 18 Profesionalni savet		

5.Kryetari i Këshillit Profesional i kryen këto punë: 5.1.Përgatit, thërret dhe udhëheq takimet e Këshillit Profesional; 5.2.Verifikon rendin e ditës së takimeve; 5.3.Siguron mbajtjen e procesverbalit të takimeve.	5.The Chairman of the Professional Council performs the following tasks: 5.1.Prepare, convenes and chairs the meetings of the Professional Council; 5.2.Verifies the agenda of meetings; 5.3.Ensures that the minutes of the meetings are kept.	5.Predsednik Stručnog saveta obavlja ove poslove: 5.1.Priprema, saziva i vodi sastanke Stručnog saveta; 5.2.Utvrđuje dnevni red sastanaka; 5.3.Obezbeđuje vođenje zapisnika na sastancima.
6.Kryetari i Këshillit Profesional është i obliguar ta thërrasë mbledhjen brenda 3 (tri) ditëve, nga dita kur këtë e kërkon drejtori i QKMF.	6.The Chairman of the Professional Council is obliged to call the meeting within 3 (three) days, from the day upon which this is requested by the director of the MFMC.	6.Predsednik Stručnog saveta je obavezan da sazove sastanak u roku od 3 (tri) dana, od trenutka kada to zahteva direktor GCPM-a.
7.Këshilli Profesional i QKMF, përveç detyrave të parapara me ligj, i kryen edhe këto detyra: 7.1.Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike; 7.2.Propozon Këshillit Drejtues dhe drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë; 7.3.Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e	7.In addition to the duties provided by law, the Professional Council performs also these duties: 7.1.Reviews and decides on the need and professional reasons for the implementation of new diagnostic and therapeutic methods and procedures; 7.2.Proposes to the Board of Directors and the director taking of professional measures to improve the organization of work and conditions for the conduction of the activity; 7.3.Proposes the structure of internal supervision, related to the work of health	7.Profesionalni savet GCPM-a, osim zadataka predviđenih zakonom, obavlja i ove zadatke: 7.1.Razmatra i odlučuje o potrebama i profesionalnim razlozima za primenu novih dijagnostičkih i terapeutskih metoda i postupaka; 7.2.Predlaže Upravnom savetu i direktoru preduzimanje stručnih mera za poboljšanje organizovanja rada i uslova za razvoj delatnosti; 7.3.Predlaže strukturu unutrašnjeg nadzora, u vezi sa radom zdravstvenih

punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale; 7.4.Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale; 7.5 Kërkon raport me shkrim nga profesionistët shëndetësor për njohuritë e fituara nga ZhVP; 7.6.Shqyrton dhe vendos për çështje të tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit Profesional.	employees as well as measures for improving the professional performance; 7.4.Reviews the need for continuous professional development and proposes to the director the sending of health employees to professional development programs/opportunities; 7.5.Requires written reports from health professionals on the knowledge gained from the CPD; 7.6.Reviews and decides on other matters, which are submitted to the Professional Council by the director.	radnika kao i mere za poboljšanje profesionalnog rada; 7.4.Razmatra potrebu za kontinuirani profesionalni razvoj i predlaže direktoru da se zdravstveni radnici šalju na profesionalno obučavanje; 7.5.Traži pismeni izveštaj od zdravstvenih stručnjaka o znanju stečenom od KPR-a; 7.6.Razmatra i odlučuje o ostalim pitanjima, koja direktor postavlja pred Upravnim savetom.
Neni 19 Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore 1.Në QKMF funksionon Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore. 2.Komiteti për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore (në vazhdim Komiteti) është një ekip multi-disciplinar i cili përbëhet nga: 2.1.1Drejtori i institucionit; 2.1.2Drejtori i infirmierisë, Kryeinfirmieri në QKMF;	Article 19 Committee on Quality and Safety of Health Services 1.There is a Committee on Quality and Safety of Health Services which operates within the MFMC. 2. The Committee on Quality and Safety of Health Services .Committee is a multi-disciplinary team consisting of the: 2.1.1Director of Institution; 2.1.2Director of Nursing Ward, Head Nurse at the MFMC;	Član 19 Komitet za kvalitet i sigurnost zdravstvenih usluga; 1.U GCPM funkcioniše Komitet za obezbeđivanje kvaliteta zdravstvenih usluga. 2.Komitet kvaliteta i obezbeđivanje zdravstvenih usluga Komitet je više-disciplinska ekipa koja se sastoji od: 2.1.1 Direktora ustanove; 2.1.2. Direktora nege, Glavne sestre u GCPM-u;

2.1.3Koordinatori për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore; 2.1.4Drejtori shëndetësor, Kryeshefi i Departamentit në MF; 2.1.5Drejtori operativ-administrates, Kryeshefi i administratës në KPSh; 2.2Varësisht nga institucioni shëndetësor, ky komitet mund të ketë edhe anëtarë të tjerë; 2.3Detyrat dhe përgjegjësitë e komitetit janë të bazuara në dispozitat e statutit të institucionit shëndetësor.	2.1.3Coordinator for ensuring the quality and safety of health services; 2.1.4Health Director, Chief of Department in the PHC; 2.1.5Director of Operations-Administration, Chief of Administration in the PHC; 2.2Depending on the health institution, this committee may have other members, as well; 2.3The duties and responsibilities of the committee are based on the provisions of the statute of the health institution.	2.1.3. Koordinator za obezbeđivanje kvaliteta i obezbeđivanje zdravstvenih usluga; 2.1.4. Direktor zdravlja, Glavni šef odeljenja u PM-u; 2.1.5. Operativni-administracioni direktor, Glavni šef administracije u ISZ-u; 2.2. Zavisno od zdravstvene ustanove, ovaj komitet može imati i druge članove; 2.3. Zadaci i odgovornosti komiteta su osnovane prema odredbama statuta zdravstvene ustanove.
Neni 20 Komisioni Etik-Profesional Komisioni Etik - Profesional është trup i cili denoncon rastet e shkeljeve sipas ligjit për odat e profesionistëve shëndetësor.	Article 20 Professional Ethics Commission The Professional Ethics Commission is a body that reports the cases of violations pursuant to the law on chambers of healthcare professionals.	Član 20 Etičko-profesionalna komisija Eričko-profesionalna komisija je telo koje osuđuje slučajeve kršenja po zakonu za komore zdravstvenih stručnjaka.
Neni 21 Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjerë përcaktohen me aktet nënligjore, të nxjerra nga Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga MSH.	Article 21 Duties and responsibilities of other bodies are defined by sub-legal acts, issued by the Board of Directors, through the Director of MFMC, if they are not defined by other acts of the MoH.	Član 21 Zadaci i odgovornosti ostalih tela se određuju podzakonskim aktima, usvojenih od Upravnog saveta, preko direktora GCPM-a, ukoliko one nisu određene ostalim aktima od strane MZ.

Neni 22 Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional	Article 22 Continous Professional Development	Član 22 Kontinuirani profesionalni razvoj
